

*“Derisa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

VËLLAZËRIA NË ISLAM DHE ZEMRA E SHËNDOSHË

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

الأخوة بين المسلمين و سلامة الصدر

Titulli:

**VËLLAZËRIA NË ISLAM DHE
ZEMRA E SHËNDOSHË**

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2006

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, ndërsa cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përsëhëndesim dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin , robin e Allahut dhe të Dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përsëhëndesim edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Ajo çka po ndodhë për çdo ditë tek muslimanët si: nënçmimi i ndërsjellët, urrejtja në mes vete, problemet, ndarja, përçarja, copëtimi, konfrontimi, hidhërimi etj., të gjitha këto na obligojnë neve që patjetër t'i lëmë dhe të largohemi prej

kundërshtimeve mes vete, konfrontimeve, hidhërimëve, nënçmimeve. Të gjitha këto na obligojnë të mbjellim parimin e vëllazërimit dhe çlirimin e zemrave në gjokset tonë, para se të bëhet vonë dhe para se të na shkojë jeta pa bërë punë të mira. Të gjitha këto na obligojnë domosdoshmërinë që sa më shpejt të kthehemi tek Allahu Gjithëfalës dhe i Gjithëfuqishëm; t'i lëmë anash konfrontimet, kundërshtimet, hidhërimet, nënçmimet dhe t'i lutemi Allahut që t'i lartësojë dhe t'i ngritë muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, njëherit t'i mbrojë muslimanët nga nënçmimi, poshtërimi, ndarja, përçarja dhe shpërndarja.

Le të jetojnë në këtë dunja (botë) me nderë, fuqi, zhvillim dhe qeverisje, ndërsa në botën tjetër me vendbanimet me të larta të Xhenetit dhe shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit. Kjo do të jetë vërejtje dhe dëshmi se vërtetë - **“Allahu kurrë nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”**

(Err Rra`d, 11)

Kështu deri sa të arrijmë me këtë parim (maksimë) në çështjet më të rëndësishme dhe më madhore. Përpos një pjese që i ka mbrojtur Allahu dhe i ka mëshiruar nga të tjerët, të tjerët janë në shkatërrim të zemrave të tyre dhe të muslimanëve, duke shkaktuar kundërshtime, konfrontime, ndarje dhe përçarje.

Duhet të angazhohemi që ta heqim këtë ves të keq dhe virusin shkatërrimtar për të kaluar jetë të lumtur, të qetë dhe të mirë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Të angazhohemi në përmirësimin dhe ndryshimin e gjendjes faktike të mjerueshme, e për të arritur në një gjendje të ndershme, të lartë, të ndërtuar mbi bazat e vëllazërimit, unitetit, fuqisë, krenarisë, deri tek triumfi dhe qeverisja islame dhe e muslimanëve.

“Vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre”.

(Err-Rra'd, 11)

* * *

Shumë ajete dhe hadithe flasin për vëllazërinë, pastërtinë e zemrës, unitetin, ndërlidhshmërinë, bashkëveprimin, ndihmën reciproke dhe po ashtu shumë ajete e hadithe flasin për të larguarit nga konfrontimet, konfliktet, fanatizmit familjar, lokalist dhe fisnorë. Dëshirojmë të shërohem nga urrejtja, zilia dhe hidhërimi i zemrave tona. Dëshirojmë që këto t'i zëvendësojmë me vëllazëri dhe dashuri vetëm për Allahun. Dëshirojmë t'i zëvendësojmë me pastërti shpirtërore derisa Allahu ta ndryshojë gjendjen, pozitën dhe statusin tonë, prej pozitës faktike të ndarjes, përçarjes, nënshtrimit, nënçmimit dhe poshtërimit.

***Nuk ka forcë dhe fuqi e cila mund të ndryshojë
diçka pos Allahut
(La havle ve la kuvvete il-la bilah)!***

Ajo çka ndodhë te muslimanët për çdo ditë, duke filluar prej urrejtjes, ndarjes, përçarjes, problemeve, ngatërresave, konflikteve, konfrontimeve, e gjithë kjo na bën me dije domosdoshmërinë e largimit nga konfliktet, konfrontimet dhe urrejtjet. E gjithë kjo na bën me dije që të kthehemi në parimin e dashurisë vëllazërore dhe pastërtisë shpirtërore, para se të bëhet vonë dhe të na shkojë jeta pa punë të mira. E gjithë kjo na bën me dije domosdoshmërinë e kthimit te i Gjithëfuqishmi dhe Falësi, dhe e nënshtrimit vetëm

ndaj Allahut të Lartmadhëruar, që pastaj Allahu t'i ngritë dhe t'i zhvillojë muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Me qëllim që t'i mbrojë muslimanët nga nënçmimi, poshtërimi, ndarja, përçarja, e të begatohen në këtë botë me fuqi, zhvillim dhe qeverisje, ndërsa në botën tjetër t'i bëjë banorë në xhenetet më të larta dhe të na shpëtojë prej zjarrit të xhehenemit.

Kjo do të jetë vërejtje dhe nxitje gjatë vendosjes së parimit të ndryshimit të statusit prej Zotit të Lartmadhëruar se -

“... All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) për derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre...”,

(Err-Rra'd, 11)

për tu angazhuar që të përmirësohet gjendja faktike e mjerueshme në shkallën më të lartë fisnike dhe krenare të ndërtuar mbi parimin e vëllazërimit, unitetit, fisnikërisë, ngritjes dhe triumfit të islamit, dhe të muslimanëve.

Për Zotin, shpresoj se ky mesazh do të sjellë dobi të secili lexues, dobi e cila do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit. Për Allahun kjo është punë e lehtë, ngase Ai është përkrahës, mbrojtës, ndihmëtar për këtë dhe në të njëjtën kohë Ai ka mundësi për çdo gjë. Pra, Allahu i Lartmadhëruar është mbrojtësi dhe përkrahësi ynë dhe nuk ka mbrojtës më të mirë se Ai.

MUSA a.s. DHE VËLLAZËRIMI VETËM PËR ALLAHUN

Po filloj të sqaroj kuptimin e vërtetë të të vëllazëruarit vetëm për Allahun, jo prej kohës së Muhamedit s.a.v.s., por prej kohës së Musa a.s., sepse te benî Israilët çështja e vëllazërisë ka domethënie të veçantë dhe madhështore.

Kur urdhëroi Allahu i Lartmadhëruar Musa a.s. që ta thërras Firaunin dhe popullin e tij: **“Shko te Firauni se vërtet ai i ka tejkaluar të gjithë kufijtë”**, shohim se Musa a.s. ka kërkuar prej Allahut të Lartmadhëruar t’i ndihmojë me vëllain e tij për Allahun, edhe pse në të njëjtën kohë ka qenë vëlla për kah nëna dhe babai. Çështja e thirrjes (daëves) ka nevojë për vëllazërim, unitet dhe bashkëpunim, deri sa të arrihet shkalla e ngritjes, fuqisë dhe udhëheqjes së robërve të Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

24. “Shko te firaoni se ai ka ngritur kokë (është bërë arrogant)”.

25. Ai (Musai) tha: “Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim!

26. Dhe më lehtëso në këtë punë timen!

27. Më zgjidh nyjën e gjuhës sime!

28. Që ta kuptojnë fjalën time!

29. Më cakto një ndihmëtar nga familja ime,

30. Harunin, vëllain tim,

- 31. Që me të të ma forcosh fuqinë time,**
32. Bëma shok atë në punën time,
33. Në mënyrë që të madhërojmë Ty më shumë,
34. Dhe të përkujtojmë Ty shpesh.
35. Vërtet, Ti je Ai që na sheh dhe na i di punët”.
36. Ai (All-llahu) tha: “O Musa, tu dha ajo që kërkove!”

(Ta Ha, 24-36)

A nuk ka mundur Musa a.s. që vetë ta lartmadhërojë Zotin e tij?! Prandaj, jo pse ai nuk ka mundur ta bëjë vet këtë, por ai ka dashur prej Zotit të Lartmadhëruar që t’ia shoqërojë vëllain e tij, që ta përkrahë dhe t’i ndihmojë në adhurim, në nënshtrim, në falënderim dhe thirrje (daëve).

Për shkakun se vëllazërimi është çështje e çmuar dhe e shtrenjtë, shohim se Allahu iu është përgjigjur dhe e ka pranuar kërkesën e Musa a.s. kur i thotë:

“Veç të është pranuar çka ke kërkuar o Musa”.

Allahu i Lartmadhëruar po ashtu këtë e tregon edhe në një ajet tjetër të Kur’anit fisnik:

“Dhe me mëshirën tonë i dhuruam atij vëllain e tij Harunin pejgamber”.

(Merjem, 53)

Kështu Allahu i Lartmadhëruar e ka ndihmuar Musa a.s. me vëllain e tij Harunin a.s., në çështjen e *daëves* (thirrjes në islam), kumtimin e fesë së tij dhe sheriatin, te Firauni dhe populli i tij.

Çështja vazhdoi kështu deri sa Musa a.s. shkoi te vendi ku agjëroi katërdhjetë ditë dhe foli me Zotin e Lartmadhëruar, ndërsa beni Israilët adhuruan viçin, kështu që Haruni u ballafaqua me problem të vështirë me beni Israilët, sa që ishte në dilemë që me forcë t'i pengojë Beni Israilët apo të durojë deri sa të kthehet Musa a.s. prej Turi Sinasë.

Po të përdorte Haruni a.s. forcën kundër tyre, atëherë ata do të ndaheshin në dy grupe: njëri grup me Harunin a.s., ndërsa grupi tjetër me Samirijun pabesimtar dhe të humbur, e prej aty do të fillonte lufta mes vete.

Po të duronte Haruni a.s. deri sa të kthehej Musa a.s., atëherë Musa a.s. do të hidhërohej për së tepërmi.

Haruni i mençur dhe i zgjuar e zgjodhi të dytën, pra durimin deri sa të kthehet Musa a.s., këtë e bëri nga frika se populli i tij do të ndahej, konfrontohej, përçahej dhe do të luftonte mes vete, dhe në të njëjtën kohë duke shpresuar kthimin e Musa a.s. te populli i tij dhe ndikimin e madh të tij, sepse ndikimi i Musa a.s. ishte më i fuqishëm se ndikimi i tij. Për këtë arsye e zgjodhi durimin, por deri sa të kthehej Musa a.s., vetëm për ta ruajtur unitetin e popullit beni Israilë dhe mospërçarjen e tyre.

Kur Musa a.s. u kthye, u hidhërua për së tepërmi, po ashtu u hidhërua edhe me Harunin saqë e kapi për mjekrën e tij.

Ja si e tregon ngjarjen Zoti i Madhëruar:

86. “Musa u kthye te populli i vet i hidhëruar e i pikëlluar dhe tha: “O populli im, a nuk u premtoi juve Zoti juaj premtim të mirë, a mos u bë kohë e gjatë e ju e harruat premtimin, ose dëshiruat të ju godasë hidhërimi nga Zoti juaj, andaj e thyet besën që ma keni dhënë?”

87. Ata thanë: “Ne nuk e thyem besën tënde me dëshirën tonë, por ne ishim ngarkuar me barrë të rënda nga stolitë e popullit e i hodhëm ato (në zjarr), e ashtu i hodhi edhe Samirija”.

88. E ai (Samirija) ua mbaroi atyre një viç me trup që pëlliste, e ata thanë: “Ky është zoti juaj dhe Zoti i Musait, po ai (Musa) e ka harruar”.

89. A nuk e kuptonin ata se ai (viçi) as nuk u përgjigjej atyre, e as nuk kishte mundësi t’ju sillte ndonjë dobi a dëm.

90. E Haruni atyre u pat thënë më parë: “O populli im, ju vetëm u sprovuat me të, sepse Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj ejani pas meje dhe më dëgjoni për këtë që po ua them”.

91. Ata i thanë: “Ne nuk do t’i ndahemi këtij (adhurimit të viçit) deri sa të kthehet Musai!”

92. Ai (Musai u kthye e) tha: “O Harun ç’të pengoi ty kur i pe se morën rrugën e gabuar,

93. E ti të mos e vazhdosh rrugën time? A mos e kundërshtove edhe ti porosinë time?”

94. Ai (Haruni) tha: “O bir i nënës sime, mos më kap as për mjekre as për flokë, se unë u frikësova se do të thuash: i përçave beni Israilët dhe nuk e ke respektuar porosinë time?”

95. Ai (Musai) tha: “E çka ishte puna jote, o Samirij?”

96. Tha (Samiriju): “Unë pashë atë që ata nuk panë, e mora një grusht nga gjurma e të dërguarit (nga fërkemi i kalit të Xhibrilit) dhe ia hodha atij (viçit) dhe kështu më mashtroi vetvetja”.

97. Ai (Musai) tha: “Prandaj, largohu sepse sa të jesh gjallë ke për të thënë: (këdo që e sheh) “Mos mu afro!” E ty të pret edhe një moment (dënim) i pathyeshëm. E ti tash shikoje zotin tënd që e adhurove bindshëm, e tani atë do ta djegim e do ta bëjmë shkrumb dhe hirin e tij do ta shpërndajmë nëpër det”.

98. I adhuruari juaj është vetëm All-llahu, që përveç Tij nuk ka zot tjetër, e dituria e Tij ka përfshirë çdo send.

(Ta Ha, 86-98)

Ky ka qenë Ixhtihadi i Harunit a.s. po ashtu edhe këtu ka qenë mospajtimi i parë i cili ka ndodhur në mes të beni Israilëve. Urtësia e Harunit a.s. ishte se dëshironte ta ruante *unitetin e beni Israilëve*, vëllazërimin dhe ruajtjen e dashurisë mes tyre.

KUR'ANI FISNIK DHE SUNETI I PASTËR DHE KUPTIMI I TË VËLLAZËRUARIT SI DHE DASHURIA VETËM PËR ALLAHUN

Kur është dërguar Pejgamberi a.s. në Meke dhe nuk kishte rrugëdalje tjetër, pos të shkonte për thirrje (daëve) në Taif, për të përhapur fenë e Allahut të Lartmadhëruar, atij iu ngushtua edhe toka, mirëpo ai shkoi atje për ta paraqitur ftesën e tij te fiset e atij vendi. Në ato kushte, Muhamedi a.s. nuk ka tentuar që të shkonte në Medine edhe pse e kishte shumë vështirë, sepse në Medinë kishte luftë të ashpër dhe konfrontim mes dy fiseve më të mëdha të Medinës, pra në mes të fisit Eys dhe Hazrexh.

Eysi dhe Hazrexhi ishin fiset më të mëdha, në mes tyre kishte pasur dashuri të ndërsjellët, bashkëpunim, bashkëveprim dhe ndihmë reciproke, mirëpo kur kishin migruar në Medine jehudët e mallkuar, prijësit e tyre lajkatar dhe tradhtarë të specializuar për ndarje dhe përçarje mes popujve dhe vendeve, kishin vendosur të jetojnë në kurriz të atyre dy fiseve. Ata kishin punuar për krijimin e prishjes së unitetit dhe krijimin e përçarjen në mes të fisit Evz dhe Hazrexh.

Kështu filloi armiqësia dhe u zhvilluan luftëra, dhe filloi shkatërrimi i tyre, për shkak të jehudive të mallkuar, e kjo është edhe gjendja faktike e muslimanëve sot.

Nuk mund të ndryshojë kush diçka, pos Allahut.

Kjo është në interes të jehudive të mallkuar, sa që ka qenë i domosdoshëm zvogëlimi i numrit të jehudive në Medine, ndërsa atë numër të vogël të mos e lejojë të krijojë përçarje, ndarje dhe konfrontim në mes të banorëve të Medinës. Kjo ka qenë preventivë (parandalesë) dhe shërim nga sëmundja e tyre, sepse ata u shitnin armatim që të dy fiseve.

Me dinakërinë dhe tradhtinë e tyre ata haptazi ishin “ndarë” në dy aleanca: aleanca e cila përkrahte fisin Evs dhe aleanca e cila përkrahte fisin Hazrexh, mirëpo fshehurazi ishin së bashku dhe kishin një projekt të përbashkët, shkatërrimin e këtyre dy fiseve.

Për këtë arsye Muhamedi a.s. në fillim të shpalljes as që mendonte të shkojë në Medine, mirëpo një ditë prej ditëve, deri sa ishte duke bërë tavaf Qabën, i takon gjashtë medinas të rinj të cilët i pyet se prej nga ishin, ata i treguan se ishin nga fisi Hazrexh. Muhamedi a.s. kërkoi që të ulen dhe të bisedojë me ta dhe tu tregojë për këtë fe madhështore. Ata iu përgjigjën thirrjes dhe që të gjashtë e pranuan islamin. E pranuan islamin dhe u dakorduan se do të takoheshin përsëri vitin tjetër. Me ata u kthyen edhe gjashtë të tjerë, kështu numri i tyre arriti në dymbëdhjetë, mirëpo ishte një befasi e veçantë, sepse nuk ishin që të gjithë nga fisi Hazrexh, sikurse herën e parë, por ishin nëntë nga fisi Hazrexh dhe tre nga fisi Evs. Muhamedi a.s. për këtë u gëzua shumë, sepse ata ia kishin arritur qëllimit për tu bashkuar, e

po ashtu ata ishin të sinqertë në besëlidhjen dhe pranimin e islamit.

Prej aty Muhamedi a.s. e pa të arsyeshme për të emigruar në Medinë për të përhapur fenë islame atje dhe prej aty në tërë botën.

Erdhi viti tjetër, dhe kur shtatëdhjetë qytetarë të Medinës e pranojnë islamin para Muhamedit a.s., të cilët gjysma prej tyre ishin nga fisi Hazrexh, ndërsa gjysma tjetër prej fisit Evs.

Atëherë Muhamedi a.s. ishte i sigurt se kishte ardhur koha për të migruar në Medinë dhe u realizua hixhreti (migrimi) mbi këtë bazë, *mbi zemrat e sinqerta e vëllazëroi fisin Evs me fisin Hazrexh; i vëllazëroi Muhaxhirët me Ensarët*. Kështu mbi bazën e vëllazërimit, sinqeritetit të zemrave të muslimanëve dhe çrrënjosjen e konfrontimeve dhe luftërave, muslimanët kaluan jetë të lumtur, të qetë dhe krenare, ndërsa islami përhapej, ngritej dhe përparonte, kurse pabesimtarët dhe kryelartët shkatërroheshin.

Si zakonisht jehudët e mallkuar tentuan shumë herë të mbjellin mollën e sherrit, por nuk ia dolën dhe nuk patën sukses, sepse Kur'anin dhe Pejgamberin s.a.v.s. e kishin pikëmbështetje. Shumë e shumë ajete zbritnin, dhe shumë e shumë hadithe tregonin për vëllazërinë, sinqeritetin e zemrave, unitetin dhe bashkëpunimin në mes vete, si dhe për çrrënjosjen e mospajtimeve, konfrontimeve, fanatizmin familjar dhe fisnor. Po përmendim disa prej tyre:

Së pari, ajete nga Kur'ani fisnik:

103. Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së Xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur.

104. Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe parandalon krimin. Të tillët janë ata të shpëtuarit.

105. E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh.

(Ali Imran, 103-105)

45. O ju që besuat, kur të konfrontoheni me ndonjë grup, përqendrohuni dhe përmendni çdo herë All-llahun që të arrini fitoren e dëshiruar.

46. Dhe respektojeni All-llahun e të Dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit.

47. Mos u bëni si ata që dolën prej shtëpive të tyre sa për krenari e për t'i parë bota, e që pengonin nga rruga e All-llahut. All-llahut nuk mund t'i shpëtojnë me atë veprim të tyre.

(El-Enfalë, 45-47)

63. Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoje gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i Gjithëfuqishëm, i Urtë.

(El-Enfalë, 63)

2. O ju që besuat! Mos i shkelni ligjet e All-llahut, as (mos e lejoni luftën në) muajin e shenjtë, as mos e pengoni therjen kurbanit, as atë me qafore (të caktuar për kurban), as (mos pengoni) ata që duke kërkuar begati nga Zoti i tyre dhe kënaqësinë e Tij, kanë mësy (për haxh) shtëpinë e shenjtë (Qaben). E kur të liroheni nga ihrami, atëherë gjahtoni. Urrejtja ndaj një populli, që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos iu shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre. Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në devotshmëri, e të mos ndihmoheni mes vete në mëkate e armiqësi. Kini frikë dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.

(El-Maide, 2)

9. Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse kthehet (pranon mosluftimin), atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, gjykoni me drejtësi, se vërtet All-llahu i do të drejtë.

10. S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe të kini frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).

(El-Huxhuratë, 9, 10)

62. Besimtarë janë ata që i besuan All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe kur janë me të (të Dërguarin) për ndonjë çështje të përbashkët (të rëndësishme), nuk largohen pa i kërkuar leje atij. S'ka dyshim se ata që kërkojnë leje prej teje, ata i besojnë All-llahut dhe të Dërguarit të Tij. E kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, lejo kë të duash, e kërko falje All-llahut për ata , se vërtet, All-llahu falë shumë e është mëshirues.

63. Thirrjen e të Dërguarit mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit. All-llahu i di ata që tërhiqen prej jush tinëzisht, prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të Dërguarit) se ata do t'i zë ndonjë telashe, ose do t'i godasë dënimi i idhtë.

(En-Nur, 62, 63)

59. O ju që besuat, nënshtrohuni All-llahut, dhe nënshtrohuni të Dërguarit dhe përgjegjësve nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, drejtojuni All-llahut dhe të Dërguarit po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.

(En-Nisa, 59)

Prej cilësive të besimtarëve është singleriteti i zemrës, lutja për besimtarët, ashtu si na ka mësuar Zoti i Lartmadhëruar:

10. Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: “Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat farë urrejtje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!”

(El-Hashr, 10)

Allahu i Lartmadhëruar i cilëson banorët e Xhenetit me zemërgjerësi ku thotë:

47. Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar.

(El-Hixhr, 47)

Së dyti, Hadithet e Muhamedit a.s.

Ebu Musa transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vërtet, besimtari për besimtarin është sikurse një fortifikatë, e cila forcohet në mes vete, nëpërmjet pjesëve të saja – dhe Pejgamberi a.s. ka bashkuar gishtat e tij”.

(Muttefekun alejhi)

Nuëman bin Beshiri transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Shembulli i besimtarëve në dashuri në mes vete, në mëshirë mes vete, në respekt dhe ndjenja të ndërsjellëta i ngjason një trupi, ashtu që nëse një pjesë e atij trupi lëndohet dhe ndjen dhembje, ankojnë dhe ndjenë dhembje të gjitha pjesët e atij trupi”.

(Sahihu Muslim 4685)

Ebu Hurejrete r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në Ditën e Kijametit, Allahu thotë: Ku janë ata të cilët janë dashur mes vete vetëm, në emër të Madhërisë Sime? Sot do t'i vendosi dhe do t'i strehojë nën hijen dhe strehimin Tim, ditë kjo, në të cilën nuk ka hije pos hijes Sime!”.

(Sahihu Muslim, 4655)

Muadh bin Xhebeli transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke thënë se Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Ata që duhen vetëm për Madhërinë Time, kanë minbera prej drite, të cilëve u kanë lakmi peygamberët dhe shehidët”.

(Suneni i Tirmidhiut)

Amr bin Abesete bin Selemija transmeton se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë se Allahu i Lartmadhëruar thotë:

*“Meritojnë dashurinë Time, ata të cilët duhen vetëm për Madhërinë Time;
meritojnë dashurinë Time, ata të cilët rreshtohen në një rresht vetëm për Madhërinë Time;
meritojnë dashurinë Time, ata të cilët vizitojnë njëri-tjetrin vetëm për Mua;
meritojnë dashurinë Time, ata të cilët afrohen njëri me tjetrin vetëm për Mua, dhe
meritojnë dashurinë Time, ata të cilët i ndihmojnë njëri-tjetrit vetëm për Mua”.*

(Musnedi i Ahmedit, 18621)

Ebi Malik El-Eshariu transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“O ju njerëz, dëgjoni me vëmendje atë çka po ua them, dhe ta dini se: Ka rob të Allahut të cilët nuk janë as peygamber, as dëshmorë, por atyre ua kanë lakmi peygamberët dhe dëshmorët, për shkak të vendit të tyre në afërsi me Allahun. Një beduin prej turmës së njerëzve i afrohet të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., ia vendos dorën Muhamedit a.s. dhe i thotë: O i Dërguar i Allahut! Njerëz të cilët as nuk janë peygamberë, as dëshmorë, ndërsa ua kanë lakmi peygamberët dhe dëshmorët për shkak të afërsisë së tyre tek Allahu! A mund të na përshkruash se kush janë ata?! Muhamedi a.s. u gëzua për pyetjen e bedunit dhe tha: “Ata janë njerëz të rëndomtë nga vise të ndryshme, të cilët nuk kanë afërsi fisi, as afërsi farefisnore, por afërsia e tyre është afërsi vetëm për Allahun, e duan njëri-tjetrin vetëm për Allahun, rreshtohen në një rresht vetëm për Allahun. Prandaj, Allahu do t’i ulë në vende të posaçme, ku aty u ndriçohen fytyrat e tyre, dhe rrobat e tyre, derisa njerëzit pikëllohen e frikohen, ata nuk frikohen, ata janë të dashurit e Allahut, për të cilët nuk ka frikë e as pikëllim”.

(Musnedi i Ahmedit, 21832)

Transmetohet nga Ebi Idriz el Havlani se ka thënë: “Hyra në xhaminë e Damaskut të Sirisë, ku aty vërejta një djalosh. Në xhami sa herë që kishte ndonjë mosmarrëveshje apo ndonjë mospajtim afroheshin tek ai, ai ua zgjidhte problemin atyre dhe e pranonin të gjithë. Pyeta kush është ai? Mu përgjigjën se është Muadh bin Xhebeli. Të nesërmen kur shkova në xhami, ai kishte arritur para meje dhe ishte duke u falur, e prita deri sa e përfundoi namazin dhe iu afrova, i dhashë Selam dhe i thash: për Zotin, unë të dua vetëm për Allahun, ai më tha: Vetëm për Allahun? - Vetëm për Allahun ia ktheva. Ai prapë më pyeti: Vetëm për Allahun? - Iu përgjigja vetëm për Allahun. Më tha: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë:

“Ata që duhen vetëm për Allahun do të kenë vende të posaçme prej drite në ditën kur nuk do të ketë hije pos hijes së Tij. Thotë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke treguar për Zotin e Tij dhe thoshte:

Meritojnë dashurinë Time, ata të cilët duhen vetëm për Madhërinë Time; Meritojnë dashurinë Time, ata të cilët rreshtohen vetëm për Madhërinë Time;

Meritojnë dashurinë Time, ata të cilët vizitojnë njëritjetrin vetëm për Madhërinë Time. Ata që duhen vetëm për Allahun do të kenë vende të posaçme prej drite nën hijen e Arshit atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër, pos hijes së Tij”.

Muhamedi a.s. vazhdimisht fliste për vëllazërimin dhe dashurinë vetëm për Allahun, vazhdimisht këshillonte për sinqeritetin e zemrës dhe vazhdimisht insistonte për të.

Sahabët i dëgjonin, i analizonin, i kuptonin këto nga Muhamedi a.s. dhe menjëherë i vepronin dhe i praktikonin me saktësi, kështu që shtojë lidhja vëllazërore dhe dashuria vetëm për Allahun në mes tyre, ndërsa Allahu i Lartmadhëruar i fisnikëronte, i ndihmonte dhe i përkrahte kundër armiqve të tyre.

Vëllezër!

Kështu është e domosdoshme që edhe ne të jemi sikur sahabët r.a. ta dëgjojmë Pejgamberin s.a.v.s. t'i analizojmë këshillat e tij, t'i kuptojmë dhe t'i praktikojmë, deri sa të dominojë lidhja vëllazërore dhe dashuria vetëm për Allahun, deri sa të bëhemi vëllezër, të cilët e duam njëri-tjetrin vetëm për Allahun.

Nocioni i vëllazërisë, dashurisë vetëm për Allahun dhe sinqeritetin e zemrës ta kuptojmë plotësisht, ta konsiderojmë çështje të rëndësishme, ndërsa çështja e vërejtjes dhe nënçmimit të muslimanëve mes vete dhe mbushja e zemrave me zili është shumë e keqe dhe shumë e rrezikshme.

Vëllezër!

Dëshirojmë ta heqim zilinë, urrejtjen dhe nënçmimin nga zemrat tona, dhe dëshirojmë t'i zëvendësojmë me vëllazërim.

* * *

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” *(nga autori Muhamed Sajim)*
2. “Islami dhe Politika” *(nga autori Jusuf Kardavi)*
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” *(nga autori Abdurrezak Nufel)*
4. “Për Kushtetutën Islame” *(nga autori Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer)*
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” *(nga autori Abduhu Abas El-Velidi)*
6. “Vlera e kohës” *(nga autori Amër Halid)*
7. “Vëllazëria muslimane” *(nga autori Amër Halid)*
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” *(nga autori Amër Halid)*